



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 gusht 2021
Nr. ref.:RK 1827/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI15/21

Parashtrues

Bersim Sulja

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit, PA1.nr.851/2020, të 19 tetorit 2020, të Gjykatës së Apelit të
Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Bersim Sulja me vendbanim në Komunën e Prizrenit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [PA1.nr.851/2020] të 19 tetorit 2020, të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

5. Më 19 janar 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 25 janar 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi, dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 2 shkurt 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi plotësimin e formularit e kërkesës së Gjykatës.
8. Më 2 shkurt 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i ofroi një kopje të saj.
9. Më 16 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë plotësimin e kërkuar, përkatësisht formularin e kërkesës së Gjykatës.
10. Më 16 prill 2021, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës me shkresë lidhur me stadin e procedurës së lëndës se deri ku ka arritur.
11. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të

Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

13. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi caktoi gjyqtaren Remzie Istrefi Peci, Gjyqtare Raportuese në vend të Gjyqtarit Bekim Sejdiu pas dorëheqjes së tij.
14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 28 korrik 2021, Gjykata shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Nga shkresat e lëndës rezulton që pala e interesuar A.H me armë i ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor duke ia dëmtuar rënde shëndetin parashtruesit të kërkesës, deri në masën e tillë sa që ka mundur të rezultojë me paaftësimin e përkohshëm, zvogëlimin e përkohshëm dhe esencial ose zvogëlimin e përhershëm të aftësisë së tij për të punuar. Rasti kishte ndodhur në hapësirën e katit të 7 të godinës banesore në ndërtim, të një kompleksi banesor në Prizren, për shkak të mosmarrëveshjeve të mëhershme që pala e interesuar A.H i kishte me pronarin e ndërtesës rreth hapje së dritareve me pamje në oborrin e tij. Në atë kohë parashtruesi ishte i angazhuar në cilësi të kryepunëtorit në procesin e ndërtimit të godinës në fjalë.
17. Më 20 dhjetor 2019, Prokuroria Themelore në Prizren (në tekstin në vijim: Prokuroria Themelore), parashtroi Aktakuzën [PP. nr. 79/2019] kundër të akuzuarit, përkatësisht palës së interesuar A.H, për shkak të veprave penale: (i) lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 e lidhur me paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: KPRK); (ii) shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 1 të KPRK-së dhe (iii) mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.
18. Më 20 dhjetor 2019, Prokuroria Themelore në Prizren, sipas aktakuzës së lartcekur, e në bazë të nenit 233 (Negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë) të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin në vijim: KPP) i parashtroi Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore) marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur në mes të Prokurorisë Themelore dhe të akuzuarit, përkatësisht palës së interesuar A.H.
19. Më 16 janar 2020, Gjykata Themelore ka mbajtur seancën lidhur me pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, me ç' rast në bazë të nenit 233 të KPP-së, vlerësoi këtë marrëveshje, dëgjoi Prokurorin e shtetit i cili përfaqësonte aktakuzën dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, të akuzuarin A.H., në prezencën e mbrojtësit të tij, dhe vlerësoi se i akuzuari kishte kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi ishte bërë vullnetarisht, pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, ka vlerësuar se nuk ishte i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, marrëveshja ishte dokumentuar dhe në mënyrë të

qartë ishte përpiluar, ishte nënshkruar nga Prokurori dhe mbrojtësi i të akuzuarit, si dhe vet i akuzuari A.H., e po ashtu edhe nga ana e kryeprokurorit, para fillimit të negociimit për pranimin e fajësisë prokurori, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij kanë pasur takime paraprake, se nuk kishte pasur parregullsi duke përfshirë ofertën që është iniciuar pranimi i fajësisë, palët janë pajtuar me të gjitha faktet dhe kushtet që i kishte propozuar prokurori, të gjitha këto fakte u prezantuan si të vërteta, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij nuk kanë pasur vërejtje apo mos pajtim lidhur me marrëveshjen, janë pajtuar në të gjitha pikat e marrëveshjes, në negociimin e marrëveshjes ishin të përfshira të gjitha palët, palëve i ju ishte dhënë mundësia që të parashtrojnë pyetje, se kishin pasur kohë të mjaftueshme për negociimin e marrëveshjes, dhe se i akuzuari kishte kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

20. Më 16 janar 2020, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P.nr. 1729/2019] shpall fajtor të akuzuarin, përkatësisht palën e interesuar A.H. për shkak të veprës penale, (i) lëndim i rëndë trupor; (ii) shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, dhe (iii) mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, ashtu që për veprën e parë penale i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga 22 maji 2019, gjer me 4 korrik 2019, si dhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak, nga 4 korriku 2019, gjer me 18 dhjetor 2019, për veprën e dytë penale i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 2.220 Euro, si dhe për veprën e tretë penale dënimi me gjobë në shumën prej 1.200 Euro. Poashtu, parashtruesi i kërkesës për realizimin e kërkesës pasurore juridike ishte udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.
21. Më 12 mars 2020, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar ankesë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe kërkesën pasurore juridike, me propozimin që Aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i ashpër.
22. Më 11 shtator 2020, Prokuroria e Apelit, përmes shkresës [PPA/II. nr.866/2020] duke u sqaruar përkitazi me ankesën e parashtruesit të kërkesës, propozoi që e njëjta të hudhet poshtë si e pa lejuar, pasi që parashtruesi i kërkesës në cilësi të të dëmtuarit në këtë çështje penale nuk ka të drejtë që të ushtrojë ankesë, në kuptim të nenit 233 paragrafi 13 të KPPK-së.
23. Më 19 tetor 2020, Gjykata e Apelit të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) përmes Aktvendimit [PA1.nr.851/2020] e hodhi si të palejuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, e ushtruar kundër Aktgjykimit [P.nr.1729/2019] të 16 janarit 2020, të Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktvendimit të kontestuar, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.
25. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij lidhur me nenin 32 të Kushtetutës, kur gjykata e shkallës së dytë, pasi që është hudhur ankesa si e palejuar, bazuar në dispozitën e nenit 233 paragrafi 13 të KPPK, me ç' rast i

është mohuar e drejta në mjete juridike efektive (ankesë), ndërsa parashtruesi i kërkesës pretendon që baza ankimore për të dëmtuarin është nga neni 381 paragrafët 1 dhe 3 të KPPK-së.

26. Pra, lidhur me shkeljen e kësaj të drejte, nga gjykata e shkallës së dytë, sipas parashtruesit të kërkesës vlen të theksohet fakti se në udhëzimin në mjetin juridik të gjykatës së shkallës së parë, theksohet që “kundër aktgjykimit, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese”, ndërsa gjykata e shkallës së dytë, ja mohoi të drejtën në ankesë.
27. Për sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson që ky nen i mundëson atij mbrojtje në cilësi të të dëmtuarit, pasi që shprehja “*çdokujt - çdokush i garantohet-gëzon të drejtë...*”. Në vijim parashtruesi i kërkesës, thekson që “*në këtë rast çdokush është, parashtruesi i kësaj kërkeje- pala e dëmtuar, pasi që për të akuzuarin, janë paraparë të drejtat shtesë.*”
28. Në kontekst të shkeljeve të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, sipas parashtruesit të kërkesës “Shqyrtimi gjyqësor” nuk ishte publik, pra komunikimi i vendimit i është dorëzuar me postë, kur gjykata ka vendosur të miratoj pranimin e fajësisë, sipas marrëveshjes të kryesit të veprës penale me prokurorin, për shkak se shqyrtimi gjyqësor nuk është mbajtur në kohën sipas njoftimit në ftesën e dorëzuar palës së dëmtuar, as që është bërë njoftimi për ditën dhe kohën e shpalljes publike të aktgjykimit.
29. Në vijim parashtruesi thekson që gjykimi nuk ishte i drejtë dhe i paanshëm, e cila vërtetohet që për tri vepra penale të shqiptohet dënimi me gjobë, si dhe me mosrespektim të dispozitave procedurale dhe materiale, të potencuara në ankesën e hudhur, të tij në cilësi të palës së dëmtuar.
30. Në vijim parashtruesi i kërkesës thekson se atij i është cenuar e drejta e qasjes në gjykatë pasi që nuk i njihet e drejta të inicioj, si paditës subsidiar, para një gjykate të themeluar me ligj. Pra, sipas parashtruesit të kërkesës, përderisa nene të caktuara të KPP-së i japin mundësinë atij që në cilësinë e të dëmtuarit të deklarohet veprime këto të cilat nuk janë përmbushur nga Prokuroria dhe rrjedhimisht ka rezultuar me shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
31. Në fund, parashtruesi i kërkesës thekson që lidhur me shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, ai shpreh habinë e tij se si ka mundësi që dikush që shpallet fajtor për veprat penale në fjalë, të dënohet me gjobë, rrjedhimisht vërtetohet se parashtruesi i kësaj kërkeje, nuk ka qenë i barabartë para ligjit. I njëjti po ashtu shpreh dyshim se vepra penale e kryer ndaj tij ka qenë për motive etnike.
32. Pra, parashtruesi thekson se përmes kësaj kërkeje nuk po pretendohet që Gjykata të lëshohet në drejtim të nxjerrjes së provave për faktet e rastit, sepse kjo është detyrë e gjykatës penale, mirëpo i njëjti e përmend këtë rrethanë me qëllim që të potencohet, siç ai pretendon “padrejtësia dhe paligjshmëria e bërë nga organet shtetërore”, që në kombinim me të gjitha pretendimet e cekura në kërkesë, paraqesin shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sipas dispozitave kushtetuese, të përmendura më lartë, e posaçërisht edhe në kualifikimin e veprës penale.

33. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) Kërkesa e tij të shpallet e pranueshme; (ii) të konstatohet se ka pasur shkelje të nenit 32, 31 paragrafët 1 dhe 2 dhe nenit 24 të Kushtetutës, me rastin e marrjes së aktykimit të Gjykatës Themelore dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit; (iii) Të shpallen kundërkushtetuese, Aktgjykimi [P.nr.1729/2019] i 16 janarit 2020, të Gjykatës Themelore dhe Aktvendimit [PA1.nr.851/2020] i 19 tetorit 2020, të Gjykatës së Apelit.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medie, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

[...]

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale

Neni 233 Negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë

[...]

13. Marrëveshja po ashtu mund të përfshijë dispozitën ku palët pajtohen për kufijtë e dënimit që do të propozohet nga ana e prokurorit të shtetit nëse i pandehuri bashkëpunon substancialisht, ndërsa nëse gjykata shqipton dënim jashta këtyre kufijve në dëm të ndonjërës prej palëve, ajo palë ka të drejtë ankese kundër vendimit mbi dënimin.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjkata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
35. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

36. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1.Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

37. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [PA1. nr. 851/2020] e 19 tetorit 2020, të Gjykatës së Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
38. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se është e rëndësishme të vlerësohet përmbushja e kriterëve të Rregullores së punës të përcaktuara përmes: (i) paragrafit 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës, e sipas të cilës, Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij; dhe (ii) pikës (b) të paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës, sipas të cilës, Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën. E para është e rëndësishme me pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me nenin 24 të Kushtetutës, ndërsa e dyta, përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me nenet 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, respektivisht.

(i) përkitazi me paragrafin 2 të Rregullit 39 të Rregullores së Punës

39. Gjykata fillimisht rikujton përmbajtjen e këtij rregulli si në vijim:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

40. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit është nxjerrë edhe në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes nenit 24 të Kushtetutës.
41. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "*qartazi e pabazuar*" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund

të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*”. (Shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 30 prillit 2020; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 275 deri më 304).

42. Gjykata rikujton që lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon duke shprehur dyshime se vepra penale e kryer ndaj tij ka qenë për motive etnike, pasi që i njëjti i përket njërit nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë.
43. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë fakt dhe nuk ka dëshmuar pretendimin për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqes një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës. (Shih rastet e Gjykatës: KI118/19, me parashtrues *Fisnik Bahtijari*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 59; KI198/13, parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014, rasti KI136/16, parashtrues: *Ibrahim Svarça*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 nëntorit 2016, paragrafi 43).
44. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që trajtimi është diskriminues nëse një individ trajtohet ndryshe nga të tjerët në pozita ose situata të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Gjykata përsërit se trajtimi i ndryshëm duhet të ndjekë një qëllim legjitim për të qenë i justifikuar dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 13 qershorit 1979 *Marckx kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 6833/74, paragrafi 33).
45. Gjykata rikujton, që fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të Kushtetutës (Shih rastin e Gjykatës: KI118/19, me parashtrues *Fisnik Bahtijari*, cituar më lartë, paragrafi 61; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së: *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, kërkesa nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
46. Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës përtej referimit në nenin e lartcekur të Kushtetutës dhe përtej formulimit të pretendimeve në formë të përgjithësuar, nuk ka argumentuar në mënyrë të qartë dhe adekuate se si mund të jetë cenuar ky nen përmes Vendimit të kontestuar. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, bien në kategorinë e pretendimeve “*të pambështetura apo paarsyetuara*” dhe si të tilla të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Përkitazi me pikën (b) të paragrafit 3 të Rregullit 39 të Rregullores së Punës

47. Gjykata fillimisht rikujton përmbajtjen e këtij rregulli si në vijim:

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

48. Siç është cekur më lart, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata duhet të vlerësojë plotësimin e kriterëve të përcaktuara përmes pikës (b) të paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës, sipas të cilës, Gjykata mund të konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
49. Kjo sepse rrethanat e rastit konkret ngërthejnë një procedurë penale e cila ishte zhvilluar kundër palës së interesuar, përkatësisht personit A.H., me ç' rast ky i fundit ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprave penale lëndim i rëndë trupor, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve. Në këtë çështje penale parashtruesi i kërkesës e kishte statusin e të dëmtuarit. Gjithashtu nga Gjykata Themelore ishte pranuar Marrëveshja për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të Prokurorit të Shtetit dhe palës së interesuar A.H, ku për veprën e parë penale i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, në të cilin dënim i ishte llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga 22 maji 2019, gjer më 4 korrik 2019, si dhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak, nga 4 korriku 2019, gjer më 18 dhjetor 2019, për veprën e dytë penale i ishte shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 2.220 Euro, si dhe për veprën e tretë penale dënimi me gjobë në shumën prej 1.200 Euro. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës për realizimin e kërkesës pasurore juridike ishte udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe kërkesën pasurore juridike, me propozimin që Aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i ashpër. Në anën tjetër Prokuroria e Apelit propozoi që ankesa të hudhet poshtë si e pa lejuar, pasi që parashtruesi i kërkesës në cilësi të të dëmtuarit në këtë çështje penale nuk ka të drejtë që të ushtrojë ankesë, në kuptim të nenit 233 paragrafi 13 të KPPK-së. Përfundimisht, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit e hodhi si të palejuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Për pasojë parashtruesi i kërkesës para Gjykatës konteston këtë Aktvendim të Gjykatës së Apelit që ndërlidhet me një “akuzë penale” kundër një personi të tretë, me pretendimin se janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese.
50. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet praktikës së saj relevante gjyqësore e që ndërlidhet me rrethana në të cilat parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me Kushtetutë si rezultat i vendimeve të gjykatave të rregullta përkitazi me procedura penale kundër personave të tretë. Në rrethana të tilla, Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave

për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar që të interpretoj të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, ka vendosur se kërkesa të tilla, në parim, nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, duke i shpallur rrjedhimisht si kërkesa të papranueshme. Këto raste përfshijnë por nuk janë të kufizuara në rastet e Gjykatës: KI75/19, me parashtrues *Naim Prokshi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 21 prillit 2020; KI97/14, me parashtrues, *Velibor Jokić*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2015; KI52/18, me parashtrues, *Zoran Stanišić*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 janarit 2019; dhe KI12/19, me parashtrues *Arben Mërxha*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 majit 2019, e të cilat janë të bazuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duke përfshirë por mos u kufizuar në rastet *István Rékási kundër Hungarisë*, Vendim i 25 nëntorit 1996, e *Perez kundër Francës*, Aktgjykim i 12 shtatorit 2004.

51. Arsyeshmëria e kësaj praktike gjyqësore ndërlidhet me interpretimin e nenit 6 të KEDNJ-së nga GJEDNJ, e që, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet me shprehjet "*për cilëndo akuzë penale*" dhe "*të drejtat dhe obligimet*", si pjesë përbërëse të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
52. Përkitazi me të parën, është theksuar se interpretimi i shprehjes "*për cilëndo akuzë penale*" të përfshirë në nenin 31 të Kushtetutës në dritën e nenit 6 të KEDNJ-së, rezulton në konstatimin se e njëjta nënkupton "*cilëndo akuzë penale të ngritur kundër parashtruesit të kërkesës*". Në këtë mënyrë, pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre themelore si pasojë e akuzave penale të cilat nuk janë ngritur kundër tyre, por kundër personave të tretë, nuk mund të bien brenda fushëveprimit të shprehjes "*për cilëndo akuzë penale*" të përfshirë në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih në këtë aspekt rastet e Gjykatës, KI 97/14, me parashtrues *Velibor Jokić*, cituar më lart, paragrafi 35; KI52/18 me parashtrues *Zoran Stanišić*, cituar më lart, paragrafi 49; dhe KI12/19, me parashtrues *Arben Mërxha*, cituar më lart, paragrafi 40).
53. Në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu ka theksuar se Kushtetuta dhe KEDNJ "*nuk sigurojnë të drejtën e ndjekjes ose dënimit të një pale të tretë për një vepër penale. As Kushtetuta nuk ofron një të drejtë të tillë*". (Shih rastet e Gjykatës KI75/19, me parashtrues *Naim Prokshi*, cituar më lartë, paragrafi 36; KI97/14, me parashtrues *Velibor Jokić*, cituar më lart, paragrafi 38; KI52/18, me parashtrues *Zoran Stanišić*, cituar më lart, paragrafi 51; dhe KI12/19, me parashtrues *Arben Mërxha*, cituar më lart, paragrafi 39).
54. Ndërsa, përkitazi me çështjen e dytë, përkatësisht, interpretimin e shprehjes "*të drejtat dhe obligimet*" të përfshirë në nenin 31 të Kushtetutës në dritën e nenit 6 të KEDNJ-së, rezulton në konstatimin se e njëjta, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, nuk nënkupton të drejtën për të ndjekur penalisht palët e treta, por se ushtrimi i kësaj të drejte në kontekst të rrethanave që ndërlidhet me një akuzë penale kundër një personi të tretë, nënkupton mundësinë e ushtrimit të një të drejte të viktimës në procedurë civile për të siguruar dëmshpërblim simbolik ose për të mbrojtur një të drejtë civile, duke përfshirë edhe ato që mund të ndërlidhen me reputacionin. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Perez kundër Francës*, cituar më lart, paragrafët 70 e 71; e *Rekić kundër Bosnje Hercegovinës*, Vendim i 29 marsit 2018, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KI 97/14, me parashtrues *Velibor Jokić*, cituar më lart, paragrafi 36; KI52/18, me parashtrues *Zoran*

Stanišić, cituar më lart, paragrafi 50; dhe KI12/19, me parashtrues Arben Mërxha, cituar më lart, paragrafi 41).

55. Në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu rikujton rastin e GJEDNJ-së *Istváné Rékási kundër Hungarisë*, përmes të cilit, ndër tjerash, ishte theksuar:

"[...] përderisa ruan parimin e përgjithshëm se e drejta për të gëzuar një reputacion të mirë përbën një "të drejtë civile" në kuptimin e dispozitës së mësipërme, Komisioni megjithatë konsideron që procedurat e zgjedhura nga kërkuesi për [...] fillimin e procedurës penale, nuk hyjnë në fushën e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës. Për dallim nga një veprim civil [...] qëllimi i procedurës penale në fjalë është të ndëshkojë personin e akuzuar në fjalë për kryerjen e një vepre penale. Sidoqoftë, e drejta e qasjes në gjykata të cilat neni 6 paragrafi 1 i Konventës, ia mundëson secilit që kërkon përcaktimin e të drejtave të tij civile, mirëpo nuk përfshin ndonjë të drejtë për të ngritur procedurë penale kundër një personi të tretë."

56. Gjykata rithekson se edhe rrethanat e rastit konkret, ngërthejnë pretendime për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës e të cilat ndërliiden me rezultatet e procedurës penale, si pasojë e "*akuzës penale*" ndaj një personit të tretë, dhe ndaj të cilit, gjykatat e rregullta kishin nxjerrë vendim dënues. Për më tepër që, as rrethanat e rastit dhe as pretendimet e parashtruesit të kërkesës nuk ngërthejnë mundësinë dhe as nuk ndërliiden me asnjë kontest civil dhe i cili do të mund të kishte rezultuar si pasojë e ushtrimit të ndonjë të drejte të viktimës e të ndërliidhur me procedurën e zhvilluar penale kundër një personi të tretë.
57. Prandaj, siç u sqarua më lart, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe atë të Gjykatës, pretendimet e tilla të parashtruesit të kërkesës nuk hyjnë në fushëveprimin e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
58. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, ky nen lexohet në lidhshmëri me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, si dhe me praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së.
59. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në parim, qëllimi i nenit 13 të KEDNJ-së është të ofrojë një mjet juridik përmes të cilit individët mund të arrijnë një zgjidhje efektive për shkeljet e të drejtave të tyre të garantuara përmes KEDNJ-së në nivelin vendor, përpara se të vihet në lëvizje makineria e ankesave para GJEDNJ-së. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Kudla kundër Polonisë*, Aktgjykim i 26 tetorit 2000, paragrafi 152). Në të kundërtën, mungesa e ekzistencës së mjeteve juridike përkatëse, do të dobësonte dhe do t'i bënte iluzore garancitë e nenit 13 të KEDNJ-së, ndërsa kjo e fundit, siç është theksuar tashmë, nuk synon të garantojë të drejta "*teorike ose iluzore*", por të drejta që janë "*praktike dhe efektive*". (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ, *Scordino kundër Italisë* (nr. 1), Aktgjykim i 29 marsit 2006, paragrafi 192).
60. Për më tepër, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, kjo praktikë gjyqësore lidhur me interpretimin e nenit 13 të KEDNJ-së, thekson se kur një individ ka një pretendim "*të argumentueshëm*" se është viktimë e një shkeljeje të të drejtave të përcaktuara nga KEDNJ, ai/ajo duhet të ketë një mjet juridik

përpara një “*autoriteti kombëtar*”, dhe i cili i mundëson vendosjen mbi thelbin e pretendimit përkatës por dhe, nëse është e përshtatshme, të i mundëson realizimin e korrigjimit të duhur.

61. Megjithatë GJEDNJ ka theksuar se neni 13 i KEDNJ-së, nuk mund të interpretohet që kërkon një mjet juridik në të drejtën vendore për sa i përket secilës ankesë të supozuar që një individ mund të ketë, pa marrë parasysh se sa jomeritore mund të jetë ankesa përkatëse: ankesa/prendimi në çdo rast duhet të jetë “*e argumentueshme*” për sa i përket KEDNJ-së. (Shih, mes tjerash, rastet e GJEDNJ-së, *Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 52; dhe *Maurice kundër Francës*, Aktgjykim i 6 tetorit 2005, paragrafi 106).
62. Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret Vendimi i kontestuar, nuk prek të drejtat dhe detyrimet civile të parashtruesit të kërkesës. Ankesat e parashtruesit, në thelb, kanë të bëjnë me mosdënimin meritore të palës së interesuar A.H.; çka nënkupton se të drejtat dhe detyrimet personale të parashtruesit të kërkesës nuk kanë qenë objekt shqyrtimi nga gjykatat e rregullta.
63. Për më tepër, siç përcaktohet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, as neni 13 (E Drejta për Zgjidhje Efektive) e as ndonjë dispozitë tjetër e Konventës nuk i garanton një parashtruesi të kërkesës të drejtën për të siguruar ndjekjen penale dhe dënimin e një pale të tretë ose të drejtën për “*hakmarrje private*” (shih rastet e GJEDNJ-së: *Öneryildiz kundër Turqisë*, kërkesa nr. 48939/99, Aktgjykim i 30 nëntorit 2004; *Perez kundër Francës*, kërkesa nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 70).
64. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk njohin të drejtën për ndjekje apo dënim të palëve të treta (shih *Perez kundër Francës*, paragrafi 70); çka në të vërtetë, paraqet thelbin e kërkesës së parashtruesit sepse ai është i pakënaqur që përmes Vendimit të kontestuar nuk i është mundësuar dënimi më i ashpër lidhur me palën e interesuar A.H.
65. Prandaj, duke qenë se në rastin konkret Vendimi i kontestuar nuk përcakton dhe as nuk prekë në asnjë mënyrë të drejtat dhe detyrimet personale të parashtruesit, kërkesa e tij dhe pretendimi për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, është e papajtueshme me juridiksionin material (*ratione materiae*) të Gjykatës.
66. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit duhet të shpallet e papranueshme, për shkak se është e papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës.
67. Si rezultat, kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të shpallet e papranueshme bazuar në (i) në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës lidhur me pretendimet e tij përkitazi me shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës; dhe (ii) pikën b) të paragrafit 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës lidhur me pretendimet e tij përkitazi me shkeljet e neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës në lidhje me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 e 48 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 39 (3) (b) të Rregullores së punës, më 28 korrik 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Remzie Istrefi Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani